

## PYETJET MË TË SHPESHTA

### Konkursi BABILON 2017 për përkthyes më të mirë të ri

#### Pyetje nga studentët dhe aplikuesit lidhur me konkursin

1. Unë tashmë jam 26 vjeç; a kam të drejtë të aplikoj për këtë konkurs?  
**Gjithkush që është 26 vjeç më 3 prill 2017, mund të aplikojë.**
2. Kur duhet të jetë botuar punimi original, në vitin 2013 apo 2014?  
**Jo para 3 prillit 2014, tre vjet para 3 prillit 2017.**
3. A duhet që vepra origjinale të mos jetë e përkthyer në nga shtëpitë botuese maqedonisht\*?  
**Vepra origjinale nuk duhet të jetë e përkthyer më parë në gjuhët që fliten në vend nga asnjë shtëpi botuese në BE dhe në rajon.**
4. Nëse vepra origjinale është në anglisht, a duhet që autori doemos të jetë anglez apo mund të jetë amerikan?  
**Shtetësia e autorit nuk është relevante, mirëpo vepra origjinale duhet të jetë botuar nga shtëpi botuese në BE.**
5. A duhet që vepra origjinale të jetë botuar në BE?  
**Po.**
6. Sa liri kemi për të përdorur shënime të përkthyesit?  
**Përkthyesit janë të lirë të përdorin shënime të përkthyesit, mirëpo duhet të jenë të kujdesshëm që të mos shkëpusin lexuesin me sqarime të tepërta ose të mos përdorin ato për të justifikuar zgjedhjet/zgjidhjet e tyre të përkthimit.**
7. A duhet të korrigohet teksti i përkthyer?  
**Korrigjimi i tekstit të përkthyer nuk është i domosdoshëm. Aplikuesit përgjigjen vetëm për përkthimin në tërësi; korrigjimi i tekstit të përkthyer është zgjedhje e aplikantit. Aplikanti-përkthyesi mund të jetë koautor me lektorin, dhe në këtë rast lektori duhet t'i plotësojë kriteret e njejtë të konkursit dhe duhet të përfshihet në formularët e aplikimit.**
8. Unë kam njohuri të plotë të gjuhës spanjolle, të mbështetur me një certifikatë. Në të njëjtën kohë, nuk jam përkthyes i certifikuar në gjykatë. A kam të drejtë të aplikoj për konkursin apo ky konkurs është i hapur vetëm për një grup të caktuar të përkthyesve?  
**Konkursi nuk është i kufizuar për asnjë grup të përkthyesve. Kufizimet e vetme janë mosha e aplikantit dhe gjuhët nga të cilat dhe në të cilat duhet të bëhet përkthimi.**
9. A ekziston ndonjë listë e teksteve nga të cilat përkthyesi duhet të zgjedhë për të përkthyer?  
**Aplikantët kanë të drejtë të zgjedhin vet tekstin, në pajtim me kriteret e konkursit.**
10. A ekziston ndonjë faqe interneti ku aplikanti mund të kontrollojë nëse teksti i zgjedhur është i përkthyer më parë në gjuhën maqedone? \*  
**Faqja e internetit që mund të ofrojë informata të dobishme për aplikantët është baza e të dhënave bibliografike/katalogu, e cila përbëhet nga kontribute të bibliotekave nacionale, e cila është në dispozicion në linkun në vijim: <http://www.vbm.mk/scripts/cobiss?ukaz=GETID>**
11. Si mund të di nëse teksti është botuar në Bashkimin Evropian (duke marrë parasysh se autori i tekstit mund të ketë shtetësi tjetër)?

**Teksti original duhet fillimisht të jetë botuar në BE në tre vitet e fundit. Detajet e botimit të tekstit original mund të gjenden nëpërmjet të kërkimit në Internet, duke marrë parasysh rëndësinë e vërtetimit nëse është botimi i parë apo ndonjë botim tjetër i tekstit original. Për tekstet origjinale në letër, detajet janë të përfshira në vet botimin e tekstit. Për shembull, në rast se aplikanti përkthen një pjesë të një romani, hulumtimet në Internet mund të ndihmojnë në identifikimin e detajeve të botimit të parë të romanit.**

**Ekzistojnë disa mënyra në të cilat aplikanti mund të gjejë tekstin, përveç Internetit; nëse rrethanat e lejojnë një gjë të tillë, burimi original mund të porositet apo të huazohet nga ndonjë bibliotekë ose ndonjë burim tjetër, kurse faqet mund të skenohen më vonë si pjesë e një aplikimi elektronik. Sa i përket shkrimtarit, pavarësisht origjinës së tij/saj, rekomandohet që ai/ajo të jetojë dhe punojë në një Shtet Anëtar të BE-së dhe të shkruajë në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të BE-së.**

12. A luajnë ndonjë rol të drejtat e autorit në aplikimin? Nëse ndonjë libër është i botuar në BE në 3 vitet e kaluara, ai mund të jetë ende në treg dhe përkthimi i tij mund të jetë shkelje e të drejtat të autorit, ose oq?

**Sa i përket të drejtave të autorit, përkthimi i një pjese ose të veprës në tërësi nuk paraqet shkelje e të drejtave të autorit, pasi që përkthimi nuk do të publikohet. Një nga shpërblimet përfshin publikim vetëm të përkthimit fitues në revistën Kulturen Zivot, pjesërisht ose në tërësi, por jo më shumë se 19 – 20 faqe, me ç'rast, për arsye të hapësirës së kufizuar për tekstin e përkthyer që do të publikohet, nuk paraqet shkelje e të drejtave të autorit. Që të jetë më qartë, kufizimi i paraparë, që përshkruhet me ligj për këtë sferë do të respektohet në lidhje me publikim e përkthimit të publikuar në këtë revistë.**

13. A është i lejuar përkthimi i një vepre në tërësi, për shembull përkthim të një romani prej 150 faqe, dhe cili është kufizimi për gjatësinë maksimale të teksteve?

**Sa i përket gjatësisë së tekstit, aplikuesi mund të dërgoj numër të faqeve sipas zgjedhjes së tij, por jo më pak se 20 faqe, siç është përcaktuar në vet konkursin. Aplikuesi mund të dërgoj përkthim të një vepre në tërësi, dhe në bazë të kushteve të konkursit, publikimi i paraparë do ti përfshij vetëm përkthimet fituese, të cilat do të publikohen pjesërisht ose në tërësi në revistën Kulturen Zivot.**

14. Cilat dokumente më duhen për të aplikuar?

**Punimet duhet të dorëzohen me një kod, të cilin e krijon aplikanti dhe i cili përmban pesë karaktere, dhe secili me një formular të veçantë të punimit. Çdo punim duhet të përmbajë: a) një letër motivimi, b) një formular të plotësuar mirë, c) një kopje të tekstit original, d) një kopje të tekstit të përkthyer, dhe e) një deklaratë të nënshkruar se punimi është përkthyer nga teksti burimor në gjuhën e vet origjinale. Aplikantët duhet të dërgojnë një letër motivacioni, një formular të plotësuar dhe një kopje të kartelës së tyre të identifikimit në adresën në vijim:**

**EU InfoCentre**

**(for the BABYLON BEST YOUNG TRANSLATOR COMPETITION)**

**Sv Kiril i Metodij 52b, 1000 Skopje**

**Or to the following e-mail address: [Babyroncompetition@euic.mk](mailto:Babyroncompetition@euic.mk)**

15. A duhet që përkthimet të dërgohen në suaza të afatit, më 03 prill?

**Po, aplikacionet e plotësuar duhet të dorëzohen deri më 03 prill (shih më lartë).**

*\* Pyetjet u parashtruan nga studentët pjesëmarrës të punëtorisë, e cila u mbajt më 16 dhjetor në Qendrën Informative të BE-së dhe nga aplikantët potencialë përmes Qendrës Informative të BE-së.*